



Origjinali: Frëngjisht

Nr.: ICC-02/05-01/07

Datë: 4 qershor 2007

DHOMA I E SEANCËS PARA-GJYQËSORE

DHOMA I E SEANCËS PARAGJYQËSORE:

Gjyqtare Akua Kuenyehia, Kryetare e Trupit Gjykses
Gjyqtar Claude Jorda
Gjyqtare Sylvia Steiner

Regjistrar:

Mr Bruno Cathala

**SITUATA NË DARFUR, SUDAN
NË ÇËSHTJEN**

*E PROKURORIT kundër. AHMAD MUHAMMAD HARUN ("AHMAD HARUN")
dhe ALI MUHAMMAD ALI ABD-AL-RAHMAN ("ALI KUSHAYB")*

Dokument Publik

**KËRKESË SHITETEVE ANËTARE NË STATUTIN E ROMËS PËR
ARRESTIMIN DHE DORËZIMIN E AHMAD HARUN**

Zyra e Prokurorit

Z. Luis Moreno-Ocampo, Prokuror

Znj. Fatou Bensouda, Zëvendës Prokuror

Z. Andrew Cayley, Avokat Mbrojtës

KANCELARI i Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve (“Gjykata”);

DUKE PASUR PARASYSH referimin e situatës në Darfur për Prokurorin e Gjykatës nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në rezolutën e tij 1593 të 31 marsit 2005;

DUKE PASUR PARASYSH vendimin e marrë më 27 prill 2007 nga Dhoma I e Seancës Para-Gjyqësore (“Dhoma”) për të lëshuar urdhër-arrestet për Ahmad Muhammad Harun (“Ahmad Harun”) dhe Ali Muhammad Ali Abd-al-Rahman (“Ali Kushayb”), dhe ngarkimin e Kancelarit të Gjykatës me detyrën e përgatitjes dhe transmetimit, në përputhje me rregullin 176 të *Rregullave të Procedurës dhe Fakteve*, të kërkesave për arrestimin dhe dorëzimin e Ahmad Harun dhe Ali Kushayb, Shteteve Anëtare në *Statutin e Romës* (“Statuti”);¹

DUKE PASUR PARASYSH urdhër-arrestin për Ahmad Harun të lëshuar më 27 prill 2007 nga Dhoma sipas nenit 58 të Statutit;²

DUKE PASUR PARASYSH nenet 19, 20, 57, 60, 67, 87, 89, 91 dhe 97 të Statutit, rregullat 21, 117 deri 119, 176, 184 dhe 187 të *Rregullave të Procedurës dhe Fakteve* dhe rregullat 31, 76 dhe 111 të *Rregullave të Gjykatës*;

DUKE KONSIDERUAR që neni 89(1) i Statutit parashikon që Gjykata mund t’i transmetojë një kërkesë për arrestimin dhe dorëzimin e një personi kujtdo Shteti në territorin e të cilit mund të ndodhet ai person;

¹ ICC-02/05-01/07-1.

² ICC-02/05-01/07-2.

KËRKON që personi i mëposhtëm të arrestohet dhe dorëzohet sipas vendimit të datës 27 prill 2007 dhe në vijim të urdhër-arrestit:

- Emri: Ahmad Muhammad Harun (“Ahmad Harun” i shkruar gjithashtu: Ahmed Haroun, Mohamed Ahmed Haroun dhe Ahmed Haroon);
- Moshë: Mendohet që ai të jetë rreth 43 vjeç;
- Shtetësia: Mendohet që ai të jetë me shtetësi sudaneze;
- Profesioni: Ministër Shteti për Çështjet Humanitare në qeverinë aktuale të Sudanit që nga viti 2006. Gjithashtu besohet se ai ka shërbyer që nga, ose rreth prillit 2003, deri në, ose rreth shtatorit 2005, si Ministër Shteti për Punët e Brendshme në qeverinë e Sudanit;
- Akuzat: Supozohet që ai të ketë kryer krime lufte sipas nenit 8 të Statutit, midis gushtit 2003 dhe marsit 2004, dhe krime kundër njerëzimit sipas nenit 7 të Statutit, midis vitit 2003 dhe 2006 në rajonin e Darfurit;

Në rast të arrestimit dhe dorëzimit:

KËRKON që të garantohet siguria e Ahmad Harun deri në dorëzimit përfundimtar të tij Kancelarit të Gjykatës;

KËRKON, në vijim të nenit 87(4) të Statutit, që çdo informacion që mund të grumbullohet në lidhje me këtë kërkesë, të sigurohet dhe të trajtohet në një mënyrë që mbron sigurinë dhe mirëqenien fizike ose psikologjike të çdo viktime, dëshmitari të mundshëm dhe familjeve të tyre;

KËRKON që Gjykata të njoftohet për çdo kërkesë nga Ahmad Harun drejtuar ndonjë gjykatë kombëtare sipas nenit 59(3) ose 89(2) të Statutit;

KËRKON që Gjykata të njoftohet, në vijim të nenit 91(2)(c) të Statutit, për çdo dokument, deklaratë ose informacion, të ndryshëm nga urdhër-arresti dhe fotot bashkëngjitur atij, meqenëse mund të jetë e nevojshme që të plotësohen kërkesat për procesin e dorëzimit;

KËRKON që Gjykata të informohet, në vijim të nenit 97 të Statutit, për çdo problem i cili mund të pengojë ose ndalojë ekzekutimin e kësaj kërkesë;

KËRKON që Gjykata të informohet, në vijim të nenit 89(4) të Statutit, për çdo problem i cili mund të vonojë ekzekutimin e kësaj kërkesë;

KËRKON që Kancelari i Gjykatës të informohet menjëherë, në vijim të rregullit 184 të *Rregullave të Procedurës dhe Fakteve*, kur Ahmad Harun të jetë i gatshëm për t'u dorëzuar;

KËRKON që Ahmad Harun të dërgohet në Gjykatë sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të jetë caktuar që ai do të dorëzohet;

RIKUJTON detyrimin për të vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 59 të Statutit;

I BASHKËNGJIT kësaj kërkesë, në përputhje me nenet 87 dhe 91 të Statutit, rregullin 187 të *Rregullave të Procedurës dhe Fakteve* dhe rregullin 111 të *Rregullave të Gjykatës*, dokumentet e mëposhtme në gjuhën angleze dhe arabe:

- i) një kopje të urdhër-arrestit për Ahmad Harun të lëshuar më 27 prill 2007, të cilit i janë bashkëngjitur dhe fotot e tij (Aneksi 1);
- ii) një kopje të dispozitave përkatëse të Statutit dhe *Rregullave të Procedurës dhe Fakteve* në një gjuhë të cilën Ahmad Harun e kupton dhe e flet plotësisht (Aneksi 2).

**Në emër të Kancelarit
Marc Dubuisson,
Kryetar i Seksionit të Shërbimeve të Gjykatës**

Datë, 4 qershor 2007

Në Hagë, Holandë